

PYETJE: «SI MUND TË ARRIHET BASHKIMI I TË GJITHË BESIMTARËVE KRISTIANË, TË CILËT FATKEQËSISHT JANË TË NDARË NË SEKTE NGA MË TË NDRYSHMET SOT?»

PËRGJIGJE: Në ditët tona, besimtarët kristianë janë të ndarë në qindra kisha të ndryshme. Sot bota mund të ketë aq shumë grupe të ndryshme fetare sa ka edhe lloje të ndryshme gjuhësh për të komunikuar!

Ne besojmë se kjo ndarje fetare është e turpshme dhe, për shkak të saj, besimtarët kristianë janë të përçarë dhe nuk meren vesh njëri me tjetrin. E dyta, kjo ndarje është e turpshme, sepse njerëz të tjerë, si pasojë e saj, influencohen për keq dhe si rrjedhim nuk i nënshtrohen vullnetit të Perëndisë. Tre misionarë fetarë, që predikonin gjëra të ndryshme nga njëri-tjetri, shkuan për një vizitë në një fis të Afrikës. Edhe pse kishin disa muaj që predikonin, asnjë nga anëtarët e atij fisi nuk ishte kthyer në një ndjekës të Krishtit. Të tre misionarët, të çuditur nga rezultatet e punës së tyre, organizuan një takim me kryeplakun e fisit për të zbuluar shkakun e mos-suksesit të tyre. Kryeplaku, pasi e dëgjoi shqetësimin e tyre, u përgjigj: «Ju doni të na tregoni për Jezusin, por ju të tre thoni gjëra të kundërta. Në fillim, mblihduni bashkë dhe bini dakord për mësimet e Jezusit. Dhe pas kësaj, ne mund t'ju dëgjojmë dhe të marrim vesh të vërtetën.» Shumë njerëz nuk kanë pranuar t'i binden Krishtit për arsye të ndarjes që ekziston midis atyre që pretendojnë se e ndjekin Atë. Dikush ka thënë: «Çmimi që kemi paguar si rezultat e ndarjes së kristianizmit është një botë e tërë e mbushur me jobesimtarë.»

Arsyja kryesore që na bën ta konsiderojmë

ndarjen fetare si një turp është fakti se ajo është e kundërta e asaj që dëshiron Perëndia. Jezusi u lut: «Tani unë nuk lutem vetëm për ta, por edhe për ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre, që të gjithë të jenë një, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë një në ne, që bota të besojë se ti më ke dërguar» (Gjoni 17:20, 21). Pali shkroi: «Tani vëllezër, ju bëj thirrje në emër të Zotit tonë Jezu Krishtit të flisni që të gjithë të njëjtën gjë dhe të mos keni ndasi midis jush, por të jeni plotësisht të bashkuar, duke pasur një mendje dhe një vullnet» (1 Korintasve 1:10).

Madje edhe në qoftë se biem dakord që ndarja fetare është e turpshme, pyetja mbetet: *Si mund të bashkohen besimtarët kristianë?* Le të vemë përballë njëra-tjetrës dy metoda që mund të na çojnë drejt unitetit.

METODA E PËRDORUR NGA NJERËZIT PËR TË ARRITUR UNITETIN

Njerëzit janë përpjekur që ta arrijnë bashkimin në dy mënyra. Mënyra e parë bazohet në konceptin e *bashkëpunimit*. Njerëzit që u përkasin grupeve të ndryshme fetare dhe që ndjekin doktrina të ndryshme bien dakord se në shumë gjëra ata nuk do të pajtohen njëri me tjetrin. Kështu, për të arritur bashkimin, ata i anashkalojnë gjërat që i ndajnë nga njëri-tjetri duke i kushtuar më shumë vëmendje pikëpamjeve të njëjta që ata kanë në lidhje me kristianizmin.

Disa herë njerëzit që bëjnë pjesë në këtë kategori

mblidhen së bashku, megjithëse u përkasin grupeve të ndryshme fetare, për t' u lutur apo për të studiuar Biblën. Ata anashkalojnë ndryshimet e shumta që kanë dhe thjesht diskutojnë për gjërat në të cilat ata të gjithë bien dakord. Ata mund edhe të formojnë një kishë të përbërë nga anëtarë të ndarjeve të ndryshme fetare. Secili prej anëtarëve të një kishe të tillë do të ketë mendimin e tij për pagëzimin, për Darkën e Zotit, drejtimin e kishës, e të tjera. Ky mendim i tij mund të jetë i ndryshëm nga mendimi i një anëtari tjetër dhe kjo nuk përbën ndonjë problem për ta.

E njëjta metodë vërehet në përpjekjet e disa kishave për të bashkëpunuar. Në këtë rast ndikimi i aplikimit të një metode të tillë është më i madh në njerëz. Kishat «harrojnë» diferencat që ekzistojnë midis tyre me synim bashkëpunimin. Mund të ndodhë gjithashtu që grupimet e ndryshme fetare të krijojnë së bashku organizata të ndryshme për të drejtuar apo mbikqyrur projekte të ndryshme që ato duan të realizojnë. Megjithëse disa grupime mund të bashkëpunojnë nëpërmjet organizatave të tilla, secili grupim (kishë) vazhdon të mbajë qëndrimet e tij. Ndërkohë të gjithë bashkëpunojnë së bashku për projekte siç mund të jenë projektet e bamirësisë apo të ungjillizimit (shpërndarjes së Fjalës së Perëndisë ndër njerëz).

A është e drejtë që bashkimin e besimtarëve ta realizojmë me anë të kësaj mënyre? Motoja e kësaj mënyre është: Për ne e rëndësishme është të tolerojmë dhe të bashkëpunojmë me njerëzit e besimeve të ndryshme. Kjo moto madje duket se ngjason me mësimet e Biblës.

Problemi është se kjo mënyrë në të vërtetë nuk zgjidh ndonjë gjë. Ajo nuk prodhon unitetin e vërtetë, por në të kundërt e fsheh dhe e anashkalon problemin. Problemi, edhe pse tani nuk duket, ekziston akoma. Edhe pse pretendojmë se diferencat tona nuk kanë rëndësi, ato *përsëri* qëndrojnë midis besimtarëve duke prodhuar ndarje dhe e keqja e ndarjes fetare akoma ekziston.

Por çfarë e bën këtë mënyrë me të vërtetë të gabuar është se uniteti i përfutur prej saj nuk është uniteti që gjendet në Bibël. Jezusi u lut që besimtarët mund të jenë një «ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty» (Gjoni 17:21). Sa të ngjashëm janë Ati me Birin? Ata kanë të njëjtin qëllim, të njëjtin plan, të njëjtën fuqi. A është ky bashkim që Bibla na mëson i njëjtë me atë që prodhohet duke ndjekur

parimin e bashkëpunimit të grupeve të ndryshme fetare? Natyrisht që jo! Pali u kërkoi Korintasve që të pajtoheshin, duke patur një mendje dhe një vullnet (1 Korintasve 1:10). Kur p.sh. gjashtë kisha të ndryshme që mbajnë emra të ndryshëm, që predikojnë metoda të ndryshme për shpëtimin e njeriut dhe nderojnë në mënyra të ndryshme bien dakord të bashkëpunojnë, a kemi realisht një bashkim të vërtetë të të gjithë anëtarëve të këtyrë kishave? A kanë ata mendje dhe vullnet të njëjtë? Jo, kjo është e pamundur të arrihet me anë të kësaj metode!

Uniteti i mësuar në faqet e Biblës është uniteti i vërtetë. Ai është i vetmi unitet që mund të bashkojë me të vërtetë të gjithë besimtarët e Perëndisë kudo që janë. Nga ana tjetër, përpjekjet për unitet me anë të parimit të bashkëpunimit në asnjë mënyrë nuk mund të prodhojnë unitetin për të cilin Bibla flet.

Metoda e dytë që njerëzit përdorin për të ndaluar ndarjen fetare është uniteti që prodhohet si rezultat i bashkimit të kishave. Kjo mund të mendohet si një *unitet me anë të kompromisit*, meqenëse kishat që bashkohen duhet të vendosin për formën që do të ketë kisha që do të formohet.

A ka diçka që nuk shkon me këtë metodë? Kjo metodë u përgjigjet në një farë mënyre kundërshtimeve që mund të krijohen kundër konceptit të «unitetit me anë të bashkëpunimit». Kjo mënyrë prodhon unitet të vërtetë. Kisha e re është në të vërtetë e bashkuar. Dy probleme ekzistojnë me aplikimin e kësaj metode.

E para, është e vështirë që të arrihet më shumë unitet me anë të kompromisit dhe si rrjedhim është gati e pamundur që të kemi më pak kisha. Në Kanada, tre kisha u bashkuan për të formuar «Kishën e Bashkuar». Kur ne jetonim në Kanada në vitet '60, Kisha e Bashkuar ishte ndoshta grupimi më i madh Protestant. Por, në të vërtetë, në Kanada ekzistonin akoma të tre kishat nga të cilat ishte formuar vetë Kisha e Bashkuar. Kur bashkimi ndodhi, bashkësi apo individë të ndryshëm që ishin kundër këtij bashkimi dhe kishës së re që ai do të sillte, vendosën që të mos bëheshin pjesë e saj. Kështu, ata qëndruan në bashkësitë e tyre të mëparshme. Unë mendoj se qëllimi i bashkimit ishte që të krijohej një kishë e vetme në vend të tri kishave të ndara. Por në të vërtetë rezultati tregoi se në vend të tre kishave, tani ekzistonin katër: tri kishat që ekzistonin në të kaluarën, *plus* bashkësia e re, Kisha e Bashkuar. Ky bashkim solli një ndarje

të mëtejshme.

Argumenti tjetër ndaj kompromisit, si mënyrë e bashkimit, është ky: Kur bashkësitë e ndryshme bashkohen për të formuar një «kishë të madhe», ne nuk mund të sigurohemi se kjo «kishë e madhe» do të jetë e pëlqyeshme nga Perëndia. Kompromisi gjithmonë bazohet në mendimet dhe traditat e njerëzve. Përfaqësuesit nga një bashkësi mund të thonë, për shembull: «Ne do të bashkëpunojmë me ju në organizimin e kishës, *në qoftë se* ju do të pranoni mënyrën tonë të nderimit.» Kompromisi nuk është rruga më e mirë për të arritur tek e vërteta. E vërteta është më e rëndësishme se uniteti. Jezusi tha: «Do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'ju bëjë të lirë» (Gjoni 8:32). Të ligjërosh gabimin, madje edhe në emër të unitetit, në asnjë mënyrë nuk mund të jetë në përputhje me vullnetin e Perëndisë. E vërteta që gjendet në Fjalën e Perëndisë është me e rëndësishme se uniteti. Ne nuk mund të cënojmë të Vërtetën për të pasur më shume unitet.

Në qoftë se ne biem dakord të bashkohemi duke mos vënë në themel të këtij bashkimi mësimet e Biblës, ne edhe mund të arrijmë të kemi «një kishë të madhe». Por, në qoftë se kjo «kishë e madhe» nuk e kënaq Perëndinë, atëherë çfarë kemi përfituar? Në mesjetë, kristianizmi ishte përqëndruar gati i tëri në «një kishë të madhe», Kishën Katolike të Romës. Dikush mund të shikojë në këtë periudhë modelin e unitetit të besimtarëve. Por a e realizoi kjo «kishë e madhe» vullnetin e Perëndisë? Pak nga ne do të bien dakord se ajo e bëri një gjë të tillë.

Si rrjedhim, bashkimi i kishave nuk është zgjidhje për problemin e ndarjes së besimtarëve sot në botë. Madje, edhe nëse ky bashkim jep një kishë, në qoftë se ajo nuk i përmbahet të vërtetës së Perëndisë, ajo qëndron prapë larg Perëndisë. Në qoftë se duam që gjithë besimtarët të bashkohen në një kishë të vetme duhet që në *fillim* të pyesim: «A është ky bashkim në përputhje me vullnetin e Perëndisë, të shprehur në Fjalën e Tij?» Vetëm *pas kësaj* në duhet të punojmë për të arritur këtë bashkim në Krishtin.

Metodën e parë të sugjeruar nga njerëzit për të arritur unitetin mund ta mendojmë si një «metodë në formën e çadrës». Ideja është që gjithë ndarjet fetare apo gjithë «kristianët» të vendosen nën të njëjtën «çadër» apo nën të njëjtën organizatë të përgjithshme dhe pastaj të gjithë do të jenë të bashkuar. Por gjërat nuk venë ashtu si planifikohen.

Metodën e dytë të sugjeruar nga njerëzit për të arritur unitetin mund ta mendojmë si një «metodë të pëzierjes» Kjo është si të bashkohesh disa lëngje të ndryshme për të formuar një lëng të ri. Ky lëng i ri, edhe pse është një i vetëm, ndoshta mund të mos jetë pëzierja e duhur. Ashtu si kombinimi i ilaçeve të ndryshme nuk mund të garantojë shërimin, në të njëjtën mënyrë as edhe kombinimi i doktrinave të kishave të ndryshme nuk mund të garantojë një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë.

METODA SIPAS BIBLËS

E dyta, krahasoni metodën e njerëzve për të arritur unitetin e besimtarëve të Krishtit me metodën e ofruar nga Bibla. Ne mund të rreshtojmë pesë karakteristika të unitetit sipas Biblës.

Uniteti sipas Biblës bazohet në Fjalën e Perëndisë. Jezusi, në lutjen e Tij për unitetin, theksoi rëndësinë e *Fjalës*. Jezusi tha se Ai u kishte dhënë apostujve Fjalën (Gjoni 17:6), ata e kishin mbajtur Fjalën (Gjoni 17:6), ata do të shenjtëroheshin nga Fjala dhe se Fjala ishte e vërteta (Gjoni 17:17, 19) dhe bota do ta besonte Jezusin përmes Fjalës së predikuar nga apostujt (Gjoni 17:20). Qartësisht, Jezusi donte që ndjekësit e Tij të ishin të bashkuar *në dëgjimin, predikimin dhe bindjen ndaj Fjalës së Perëndisë.*

Pse duhet t'i bindemi Fjalës së Perëndisë në qoftë se të gjithë ne duhet të bashkohemi në një trup?

Bindja ndaj Fjalës së Perëndisë është e nevojshme, sepse asnjëherë nuk mund të kemi unitet pa iu nënshtruar të gjithë të njëjtit autoritet. Cili është autoriteti më i madh për kristianët? Traditat fetare? Bibla? Bibla thotë se vetëm ajo është udhëzuesja e vërtetë për kristianët. Vetëm ajo është e frymëzuar nga Perëndia dhe na pajis plotësisht për çdo punë të mirë (2 Timoteut 3:16, 17). Bibla përmban «ligjin e përsosur, ligjin e lirisë» (Jakobit 1:25) dhe «besimin, që u qe trasmetuar shenjtoreve një herë e përgjithmonë» (Juda 3). Ne rilindëm me anë të Fjalës së Perëndisë dhe me anë të bindjes ndaj Tij (1 Pjetër 1:22) dhe me anë të asaj fjale do të gjykohejmë (Gjoni 12:48). Bibla është autoriteti ynë për fenë. Ne kurrë s'mund të kemi unitet pa rënë dakord më parë për autoritetin e mesazhit të gjendur në faqet e Biblës, si autoriteti i Fjalës së folur nga Perëndia.

Uniteti sipas Biblës mund të arrihet vetëm pasi t'i jeni nënshtruar Krishtit. Te Gjoni 17:21, Jezusi

tha: «Që të gjithë të jenë një, ashtu si Ti, o Atë, je në Mua dhe Unë në Ty; edhe ata të jenë një në Ne; . . .» Uniteti midis besimtarëve, mund të arrihet pasi të kemi unitet me Perëndinë dhe me Krishtin. Gjoni e shpreh qartë këtë ide te 1 Gjonit 1:7: «Por, po të ecim në dritë, sikurse ai është në dritë, kemi bashkësi njeri me tjetrin dhe gjaku i Jezu Krishtit, Birit të Tij, na pastron nga çdo mëkat.» Qëllimi i këtij uniteti është që të jemi të bashkuar apo të «kemi miqësi njëri me tjetrin». Si dhe kur arrihet ky unitet? «Duke ecur në dritë» dhe kur mëkatet tona janë të falura. Me anë të këtij vargu Gjoni thotë se vetëm kur kemi një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë ne mund të ndërtojmë marrëdhënie të drejta si besimtarë dhe të jemi të bashkuar në unitet me njëri-tjetrin.

Me një fjalë, ne do të jemi të bashkuar vetëm pasi të gjithë të bashkohemi më parë me Krishtin. Kështu, kur ne me të vërtetë bëhemi ndjekës të Jezusit, autorit të besimit tonë, vetëm atëherë ne do të kemi marrëdhënie të drejta me njëri-tjetrin.

Uniteti sipas Biblës arrihet vetëm brenda kishës. Meqënëse uniteti arrihet me anë të Krishtit, ne nuk duhet të çuditemi se ky unitet gjendet në kishën e Tij, sepse kisha është trupi i Krishtit, «plotësia e atij që mbush çdo gjë në të gjithë» (Efesianëve 1:23). Në qoftë se kisha është plotësia e Krishtit, atëherë ne nuk mund t'i përkasim Krishtit pa qenë në kishë. Kështu, në qoftë se do të jemi të bashkuar, ne jo vetëm që do të jemi ndjekësit e Krishtit, por gjithashtu duhet të jemi pjesë e kishës e cila është trupi i Tij.

Kisha është një. Jezusi premtoi të ndërtonte vetëm një kishë (Mateu 16:18). Si rrjedhim, ka vetëm një kishë (Efesianëve 4:4). Perëndia ka pajtuar si hebrenjtë ashtu edhe grekët «me Perëndinë në një trup të vetëm me anë të kryqit» (Efesianëve 2:16), me qëllim që sot të ketë vetëm një kishë, një tufë dhe një bari (Gjoni 10:16). Ata që janë në kishë janë anëtarë apo pjesë të trupit dhe pavarësisht se «ka shumë anëtarë», prapë ka veçse «një trup» (1 Korintasve 12:2). Uniteti që Krishti dëshiron për ndjekësit e Tij mund të arrihet vetëm në kishën e Tij.

Kështu, uniteti nuk mund të arrihet jashtë kishës. Dhe as nuk mund të gjendet në bashkësi të ndryshme fetare. Dhe as nuk mund të realizohet me anë të bashkimit të kishave të ndryshme. Besimtarët bashkohen në Krisht kur ata bëhen pjesëtarë të kishës së Testamentit të Ri.

Uniteti sipas Biblës do të thotë që të kesh unitet në gjërat themelore. Testamenti i Ri na mëson se ne duhet të jemi «në të njëjtën mendje». Sidoqoftë në kristianizëm, brenda kufijve të vendosur nga Bibla, ka vend për opinione apo praktika që mund të ndryshojnë nga një bashkësi besimtarësh në tjetrën.

Kishat e shekullit të parë përdornin të njëjtën doktrinë. Por prapë ekzistonin disa ndryshime në metodë. Për shembull, edhe pse të gjithë nderonin në Ditën e Zotit (të dielën), kjo nuk do të thotë se të gjithë takoheshin në të njëjtën kohë atë ditë. Gjithashtu, ata mund të kenë përdorur metoda të ndryshme për të kryer punën e Perëndisë.

Gjatë gjithë kohës kanë ekzistuar ndryshime të tilla midis kristianëve, ndryshime për «mënyrën» e kryerjes së punës së Perëndisë, për rëndësinë e aktiviteteve të ndryshme të kishës, për çështje të tjera të diskutueshme për të cilat Bibla nuk jep udhëzime të prera. Çfarë duhet të bëjnë kristianët kur kanë diferenca midis njëri-tjetrit? Ata duhet të pranojnë idenë e unitetit pa uniformitet të plotë. Ne duhet të jemi tolerant ndaj opinioneve të ndryshme.

Sidoqoftë, midis kristianëve të Testamentit të Ri kishte unitet në çështjet e fesë. Kristianët mund të kenë patur opinione të ndryshme, por ata të gjithë pajtoheshin në gjërat themelore të kristianizmit: në atë që kërkohej për t'u bërë kristian, për të punuar dhe nderuar si i tillë në kishën e Perëndisë dhe për të jetuar jetën sipas standarteve kristiane.

Uniteti sipas Biblës ruhet duke patur një sjellje të denjë. Pasi të jemi bashkuar me Krishtin duke iu bindur Atij dhe të jemi bërë pjesë e Kishës së Tij, një gjë mbetet akoma për t'u bërë: uniteti ynë duhet ruajtur duke demonstruar një sjellje të denjë.

Uniteti sipas Biblës mund të humbasë. Në kohët e Testamentit të Ri, besimtarët ishin të gjithë të bashkuar. Ata besonin dhe predikonin të njëjtat gjëra dhe ishin të gjithë në të njëjtën kishë. Sidoqoftë ata kishin nevojë për t'u këshilluar me qëllim që të parandalonin përçarjen dhe të ruanin unitetin. Pse? Sepse uniteti i tyre i vërtetë ishte në rrezik që të humbiste nga grindjet.

Pali këshilloi kristianët në Efesus: «Me çdo përlësi e zemërbutësi, me durim, duke e duruar njëri-tjetrin në dashuri, duke u përpjekur të ruani unitetin e Frymës në lidhjen e paqes» (Efesianëve 4:2, 3). Ai u kërkoi Filipianëve: «. . . bëni të plotë gëzimin tim, duke pasur të njëjtin mendim, të njëjtën dashuri, një unanimitet dhe një mendje të vetme»

(Filipianëve 2:2). Ai i këshilloi Kolosianët: «Dhe, përmbi të gjitha këto gjëra, vishni dashurinë, që është lidhja e përsosmërisë» (Kolosianëve 3:14). Ne kemi nevojë për të njëjtin mesazh.

Të gjithë pjestarët e kishës së Krishtit janë të bashkuar si një trup i vetëm. Për të qenë të bashkuar, ne duhet të veprojmë si të tillë. Është e rëndësishme që të jemi në unitet me të tjerët sipas Fjalës së Perëndisë. Por është po aq e rëndësishme që të kultivojmë ato vlera që e ushqejnë dhe e forcojnë unitetin. Disa nga këto vlera janë përlësia, butësia, durimi, toleranca, falja, respekti, vetëmohimi, nënshtrimi dhe bindja ndaj Krishtit! Mbi të gjitha, duhet të përpiqemi që të kemi dashuri, sepse dashuria «është lidhja e përsosmërisë» (Kolosianëve 3:14).

KONKLUZIONI

Uniteti sipas Biblës nuk arrihet thjesht nga bashkëpunimi i bashkësive të ndryshme dhe as nuk vjen nga kompromisi i ideve njerëzore.

Por, uniteti sipas Biblës është: (1) *i bazuar në Fjalën e Perëndisë . . .* (2) *i gjetur në Krisht . . .* (3) *si pjesëtarë të kishës . . .* (4) *në çështjet themelore . . .* (5) *që mbahet me atë të sjelljes së denjë.*

Si mund të kontribuoni ju në ndërtimin dhe mbajtjen e unitetit të besimtarëve? Cilado qoftë pikëpamja juaj, një gjë është e qartë, *ju keni nevojë që të bëheni kristian me anë të besimit në Perëndinë dhe në Krishtin si birin e Tij dhe shpëtimtarin tuaj. Pas kësaj duhet t'i bindeni vullnetit të Perëndisë duke filluar me pagëzimin në Krisht për faljen e*

mëkateve tuaja.

Ju duhet të pagëzoheni për të pranuar autoritetin e Krishtit dhe të Fjalës së Tij (Mateu 28:18–20).

Ju duhet të pagëzoheni, pasi të keni besuar në Jezus, për t'u bashkuar me Të (Galatasve 3:26–28).

Ju duhet të pagëzoheni për t'u bërë pjesëtar i një kishë kristianësh të bashkuar (1 Korintasve 12:13).

Ju duhet të pagëzoheni, sepse pagëzimi sigurisht është një nga themelet e kristianizmit. Pagëzimi ju kërkohet nga Krishti (Marku 16:15, 16) dhe është i domosdoshëm për të marrë faljen e mëkateve (Veprat 2:38). Pagëzimi është një nga shtatë «njëshat» e gjendur tek Efesianëve, kapitulli 4 (lexojeni këtë kapitull për të kuptuar më mirë se çfarë janë shtatë «njëshat».

Kur ju pagëzoheni, pasi të keni besuar në Krisht dhe të jeni penduar për mëkatet tuaja, do të bashkoheni me Krishtin dhe me të gjithë ata që e ndjekin Atë. Ky është hapi i parë që mund të ndërmerrni për të realizuar unitetin kristian. Më pas ju mund të ruani unitetin në kishë duke i dashur vëllezërit tuaj dhe duke u kujdesur për ta. Dhe ju mund të inkurajoni të tjerët që të bëhen pjesë e trupit të bashkuar të Krishtit.

Dikush ka thënë: «Të bashkuar qëndrojmë, të përçarë ne biem.» Apo si Skënderbeu u tha bashkëluftëtarëve të tij para se të vdiste: «Bashkimi bën fuqinë.» Është koha kur të gjithë duhet të kuptojmë rëndësinë e unitetit. Është koha që të fillojmë ta kërkojmë unitetin sipas mësimëve të Biblës. Kur të jemi të bashkuar sipas Biblës, *ne do të kemi sukses. Të përçarë do të dështojmë.*

Autor: Coy Roper

Marrë nga studimi: "Pyetje lidhur me besimin te Perëndia"

© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara